




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME**  
**Komiteti për Komunitete**  
Nr.01-060/01-5020/24 datë: 21.02.2024



Npi – 01/92 datë: 23.02.2024

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 23.02.2024, nxjerr këtë:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË -II- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE**  
E mbajtur më: 23.02.2024 (e premte) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, znj.Shkurte Behluli, z.Muhamet Mehmeti, në mbledhje nuk ka marrë pjesë znj.Shkurte Mustafa dhe z.Arton Demiri. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: praktikantet znj.Valmira Hoxha dhe znj.Sadbere Halili. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin prej 5 anëtarëve të Komitetit prezent në mbledhje. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 29.01.2024,
2. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024, (pas diskutimit Publik),
3. Prop-Vendim për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024,
4. Prop-Vendim për formimin e Komisioneve për ndarjen e çmimeve “Nderi i Qytetit” dhe “Qytetar Nderi”,
5. Draft-Plani i Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026,
6. Informatë nga DKA për përfundimin e gjysëm-vjetorit të parë shkollor 2023/24,
7. Informatë nga DPUKGJ lidhur me legalizimin e objekteve pa leje ndërtimi,
8. Të ndryshme.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Hapi diskutimin për rendin e ditës. Konstatoj që në mbledhje janë prezent 5 anëtarë të Komitetit, mungon Shkurte Mustafa dhe Arton Demiri.

**z.Besnik Seferi;** Përshëndetje, pajtohem me pikat e rendit të ditës, por nuk po shoh që ka përfaqësues nga drejtoritë.

**z.Idajet Rexhepi, Sekretaria e Kuvendit;** Përshëndetje, unë po dua të sçaroi se drejtori i drejtoris për buxhet dhe financa, më ka telefonuar dhe më ka treguar se i ka lindur një djalë, dhe gjendet në spital, për këtë arsye tha nuk mund të jem prezent në mbledhjen e Komitetit.

**z.Besnik Seferi;** Te bartja e të hyrave mendoj se nuk kemi se si të diskutojmë, sepse nuk mund të bëjmë rekomandim, pasi që na duhet sqarim nga drejtori. Te drejtorja e arsimit mendoj se një informatë e përgjithshme, nuk na e sqaron gjendjen e braktisjes së nxënësve nëpër shkolla, për sa i

përket Komuniteteve pakicë, prandaj nuk duhet me u diskutuar. Dmth. pika 3 nuk duhet me u diskutu, si dhe kombinimi pikave 5 dhe 6 nuk duhet me u diskutu.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Pikat 5 dhe 6 janë pika të ndryshme dhe ne mund të japim rekomandime të ndryshme. Unë mendoj se të gjitha pikat duhet me qenë në rendin e ditës.

**\* Komiteti për Komunitete, me 2 vota “Për” me 2 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”** (Kryesuesi e përdori të drejtën e votës së dyfishtë në rast kur votimi është i barabart sipas nenit 48.1 të LVL-së) kështu që rendi i ditës u miratua me 3 vota “Për” me 2 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”, ashtu siç ka ardhur, me ftesën për mbledhje.

#### Pika 1

##### Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 29.01.2024

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**\*Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 29.01.2024.**

#### Pika 2

##### Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024, (pas diskutimit Publik)

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Besnik Seferi;** Kemi propozimet nga diskutimi publik për çmimin e Çerdhes, si dhe propozimin për lirimin e anëtarëve të familjes së Veteranëve.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Konstatoj Kuorumin prej 5 anëtarëve, prezent në mbledhje.

**\* Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi që t’i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024.**

#### Pika 3

##### Prop-Vendim për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Unë e kam lexuar, dhe mendoj se tërthorazi i prekë edhe Komunitetet. Në fshatin Gjyrkocvë e kemi një familje që ka pasë dëme për arsye se ju ka djegë shtëpia.

**z.Idajet Rexhepi, Sekretaria e Kuvendit;** Sa i përket bartjes së mjeteve financiare nga të hyrat nga viti paraprak për këtë vit, bazuar në shpjegimet që i kanë dhënë drejtori dhe zyrtarët e Financave, kanë sqaruar se këto mjete mund të barten vetëm te projektet ekzistuese, që nënkupton, nuk mund të fillohen projekte të reja.

**z.Besnik Seferi;** U spjegju nga Idajeti se bartja mund të bëhet vetëm te projektet që kanë filluar e jo te projektet e reja. Për këtë arsye unë thash se nuk duhet të japim rekomandim, sepse duhet ta dimë se ku saktësisht shkojnë mjetet. Unë nuk mund të jem “pro” për ndonjë rekomandim.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Është mirë që anëtarët e Kuvendit nga ky Komitet ta përcjellin në Kuvend një kërkesë të KPK-së.

**znj.Rrezartë Ramadani;** Përshëndetje, nëse nuk ka pas vijë buxhetore në vitin 2023 atëherë nuk mundën mjetet me u bartë.

#### Pika 4

##### Prop-Vendim për formimin e Komisioneve për ndarjen e çmimeve “Nderi i Qytetit” dhe “Qytetar Nderi”

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj.Rrezartë Ramadani;** Te kjo pikë kemi përbërjen e Komisionit nga 5 anëtarë, 2 nga Kuvendi, dhe 2 nga Ekzekutivi si dhe 1 nga shoqëria civile.

**z.Besnik Seferi;** Mendoj se ne si Komitet mund të propozojmë emra, si kontribut i dhënë nga Komuniteti pakicë.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Unë nuk po them se në Komision mund të merrin pjesë edhe dikush nga Komuniteti, sepse unë besoj se Komisioni do ta merrë parasysh këtë fakt.

**z.Besnik Seferi;** Unë mendoj që z.Ibrahim Demiri e meriton një çmim.

**z. Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Unë mendoj që z.Shefki Osmani e meriton një çmim, por ne sot duhet që ta votojmë njëherë përbërjen e Komisionit.

**\* Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes të miratoi Vendimin për ndarjen e çmimeve "Nderi i Qytetit" dhe "Qytetar Nderi" ashtu siç janë propozuar.**

#### Pika 5

##### Draft-Plani i Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Unë i kam të dhënat vetëm për dy shkolla në Komunën e Shtimes, në të cilat funksionojnë Komisionet për parandalimin e braktisjes së shkollës. Ne i rekomandojmë Kuvendit që ta nxjerrë në diskutim publik, por me vërejtjen që ti kushtohet më shumë rëndësi informimit të qytetarëve.

**z.Muhamet Mehmeti;** Përshëndetje sa i përket ekipeve për parandalimin e braktisjes së shkollës, për fat të mirë ne në Komunën e Shtimes nuk kemi edhe aq shumë braktisje të madhe të nxënësve.

**znj.Rrezartë Ramadani;** Sipas statistikës kemi 6 nxënës që e kanë braktisë shkollën, por kemi edhe 16 raste që janë në proces të braktisjes. Unë jam që ti rekomandojmë Kuvendit për diskutim publik.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Konstatoj Kuorumin prej 5 anëtarëve, prezent në mbledhje.

**\*Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që ta nxjerrë në diskutim publik Draft-Planin e Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026, me propozimin që të rritet angazhimi për njoftimin e qytetarëve.**

#### Pika 6

##### Informatë nga DKA për përfundimin e gjysëm-vjetorit të parë shkollor 2023/24

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj.Rrezartë Ramadani;** Unë sa e di e kemi një sukses mjaftë alarmant, sepse kemi një sukses me mbi 50% të suksesit të pa mjaftueshëm.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Ndoshta mund të shkojmë edhe me një rekomandim për mësim plotësues për nxënësit në shkollat e mesme dhe fillore që kanë nevojë.

**z.Besnik Seferi;** Për Informatën si të tillë, unë nuk mendoj se duhet të bëjmë një rekomandim, për arsye se Idajeti e përmendi që fillimisht duhet të dihet aspekti financiar, dhe më përleu arsyetimi sepse ne tani nuk po e dimë nëse ka apo jo mundësi financiare për mësim plotësues. Pastaj unë mendoj se e kemi shumë të rëndësishme edhe çështjen e sigurisë nëpër shkolla. Ka shumë tema që nuk janë diskutuar, prandaj unë nuk jamë vetëm me shtu numrin e rekomandimeve por që ato duhet të gjejnë zbatim.

**\*Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon DKA-së që të shqyrtojë mundësin financiare dhe mundësit e tjera për organizimin e mësimin plotësues dhe ngritjen e cilësisë në shkollat e mesme dhe fillore.**

#### Pika 7

##### Informatë nga DPUKGGJ lidhur me legalizimin e objekteve pa leje ndërtimi

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Sa më kujtohet ne si Komitet i kemi rekomanduar Kuvendit që pjestarët e Komuniteteve me u liruar për ata që janë me më pak se 400 m<sup>2</sup>. Ndoshta drejtorja e bënë një fushatë më të madhe për informimin e qytetarëve, për sa i përket legalizimit të objekteve pa leje.

#### Pika 8

##### Të ndryshme

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Një qytetari nga Komuniteti Ashkali në fshatin Gjyrkocv i është djegur shtëpia si pasojë e rrymës, nuk e di nëse kemi mundësi ti ndihmojmë diqka.

**z.Besnik Seferi;** Sa i përket çështjes që e ngrite për këtë rast, unë mendoj se tani ne e kemi një mundësi të mirë që me OJQ-në "Jetimat e Ballkanit" të bashkëpunojmë dhe me këtë rast mendoj se

një rekomandim është mirë me ja bërë DSHMS-së dhe Kryetarit për ta futur në listën e ngushtë për ndërtim. Kemi informata se ai qytetar ka mebtur pa kulëm mbi kokë. Mendoj se duhet të merret një hapë në këtë drejtim.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Kemi edhe MAPL-në që i ka ndarë 3 milion eurove për ndërtimin e shtëpive, por nuk e di se sa është e vërtetë. Unë them që DSHMS-ja ta vizitojë këtë familje në Gjyrkovc dhe të marrë informata më të detajuara për rastin.

**z.Muhamet Mehmeti;** Në bazë të informatave që unë i kamë, raporti ka dalë se ai do të ketë pagesë të qirasë. Më pëlqeu propozimi i Besnikut që të futet në listë për ndërtimin e shtëpisë nga OJQ “Jetimat e Ballkanit” dhe që të jetë e para.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Le ta bënë DSHMS-ja punën e vetë në këtë çështje, po them personalisht se nuk jam që ndonjë familje me mbetë keq, e që i ka kushtet më të vështira. Unë këtë personin e kam të afërm të familjes, prandaj unë po them që kjo le të shkojë në procedurën zyrtare.

**Kryesuesi z.Bajram Ilazi;** Ju falenderojë për pjesëmarrjen në mbledhje. Meqenëse diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:19h.

Procesmbajtës  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit  
Bajram Ilazi

